

PROCEVERBAL

- I mbajtur sot më datë 29.08.2025 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
- Pasi u lexua rendi I ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 12 vota pro.
- Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 29.07.2025 me 10 vota pro dhe 2 kundër nga këshilltarët e pranishëm. Këshilltari Bledi Koçi propozoj që tek pjesa e votimit të shkruhen me erma votat.
- Miratohet fillimi I mbledhjes me këtë rend dite si më poshtë vijon:
 1. Miratimi i rendit të ditës.
 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.07.2025.
 3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha korrik 2025”.
 4. **P/Vendim** “ Për disa ndryshime në VKB nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027 ,VKB nr 3 datë 31.01.2025 për një shtesë në v.k.b nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027”.
 5. **P/Vendim** “ Për disa ndryshime në VKB nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027 ,VKB nr 3 datë 31.01.2025 për një shtesë në v.k.b nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027”.
 6. **P/Vendim** “Për miratimin e marrveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kopetencave të përbashkëta midis njësisive të vetqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të Qeverisjes Vendore, Akademia e trajnimit të Njësisive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë(TALGA).
 7. **Të ndryshme:**
 - 1.**P/Vendim** “Për miratimin e varrezave publike të lagjes Balliu, në pasurinë Nr.133/28,Zk 1652 Nj.Ad. Orenjë, Bashkia Librazhd.
 - 2.**P/Vendim** “Për miratimin për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë.
 - 3.**P/Vendim** “Për përfshirjen në listën e familjeve që përfitojnë nga programi I strehimit.
 - 4.**P/Vendim** “Për miratimin e Planit të Integritetit”.
 - 5.**P/Vendim** “Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit parashkollor në Bashkinë Librazhd.

Fillimi I mbledhjes:

P/Vendimi nr 1 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha korrik 2025”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **13 vota pro**. Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Veli Terziu, Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Habil Biçaku. (Këshilltarët e pranishëm).

2.P/Vendim “Për disa ndryshime në VKB nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027 ,VKB nr 3 datë 31.01.2025 për një shtesë në v.k.b nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027”.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Sa ka qënë kontrata për furnizimin me mish për kopshtet dhe çerdhen?

Si ka mundesi që kjo vlerë kaq e madhe të teprojë? Të kursesh lekë dhe për feminjët e kopshteve dhe çerdheve më duket diçka shumë e rëndë, biles për këtë gjë duhet ngritur zëri nga të gjithë këshilltarët.

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Unë mendoj që ju duhet të na falenderoni që kemi kursyr lekë, pasi ne funizimin për kopshtet dhe çerdhen e bëjmë në mënyrë të rregullt dhe besoj se të gjithë ju e deni që ne kushtet I kemi të mira dhe ushqimi preferohet nga feminjët, tani varet sa feminje konsumojnë ushqimin dhe ne patjeter që pjesa që ngel nuk do ta hedhim por duhet ta kursejmë fondin për diçka tjetër. Është marrveshje kuadër dhe biem dakort me operatorin.

Këshilltari Ndriçim Doda e merr fjalën.

Unë jam pro këtij vendimi dhe shumë mire që po kaloni shtesë për pagat për Policinë Bashkiake por kam një vrejte për Policinë Bashkiake, në xhirot e darkës nuk shikoj asnjë nga Policet e turnit, ku kalojnë me biçikleta me shpejtësi, luajn me top para bashkisë, duhen marre masa sa me shpejt.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Shikoj që keni hequr fondin për shkollën e Lunikut? A në këtë kohë menduat tja hiqni fondin shkollës së Lunikut?

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Shkolla e Lunikut ka qënë që të behet nëpërmjet bashkëfinancimit me Këshillin e Qarkut, por ne momentin që kemi pasur diskutime me Këshillin e Qarku kemi pasur dhe disa donatorë të huaj dhe menduam që kë fonde ti përdorim për diku tjetër dhe shkollën e Lunikut ta bëjmë njëher e mire.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me 11 vota pro dhe 3 vota kundër.

Votat pro: Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku, Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Arben Hoxha, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Habil Biçaku.

Votat kundër: Bledi Koçi, Veli Terziu, Ilir Kuka.

3. P/Vendim “Për disa ndryshime në VKB nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027, VKB nr 3 datë 31.01.2025 për një shtesë në v.k.b nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027”.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Në lidhje me këto lera betoni kur bëni pakësim fondi thoni pakësojmë me vlerë 6 milion leke dhe kur beni shtim fondi e beni 12 milion leke.

A mund të behet një lerë betoni me 6 milion lekë? A është I mjaftueshëm ky fond?

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Ne kemi filluar që keto lerat ti bejme me fuqin puntore që ne kemi dhe nuk i bejme tja japim firmës private dhe kshu kursejmë më shumë fonde.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **14 vota pro.**

Votat pro: Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku, Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Arben Hoxha, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Habil Biçaku, Bledi Koçi, Veli Terziu, Ilir Kuka.

4. P/Vendim “Për miratimin e marrveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kopetencave të përbashkëta midis njësive të vetqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të Qeverisjes Vendore, Akademia e trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA).

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Në lidhje me këtë p/vendim na ka ardhur një udhëzim nga Ministria ku do të ngrihet Akademia e trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë(TALGA).Ku do kete trajnim per punonjesit e Administrates dhe nje per ju Keshilltarët,mendoj se eshte nje gje shume e mire për të gjithë ne.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me **të gjitha votat e të pranishmëve 13 vota pro.**

Votat pro: Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Flutur Kojku ,Fiqirete Alliu,Arjana Çekrezi,Arben Hoxha,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Bujar Vreto,Habil Biçaku,Bledi Koçi,Illir Kuka.

5.P/Vendim“Për miratimin e varrezave publike të lagjes Balliu,në pasurinë Nr.133/28,Zk 1652 Nj.Ad. Orenjë,Bashkia Librazhd.

Këshilltari Ilir Kuka e merr fjalën:

Në lidhje me kë p/vendim unë jam në djeni pasi jam dhe banori I asaj zone,bëhet fjalë për dy familje ku kanë pasur sherre here pas here dhe tani lagjia e Balliut kërkon që këto varreza ti bëjnë të fisit të tyre, une jam kundër ketij P/Vendimi.

Këshilltari Ndriçim Doda e merr fjalën.

Dhe une I njoh këto dy familje dhe më e mira është që keto dy familje mos ken sherre me njëra tjetrën por të gjithet një rrugesgjidhje.

Këshilltari Bujar Vreto e merr fjalën.

I njoh shumë keto dy familje dhe di që varreza janë shumë të vjetra në fshat ,e mira është që mos të ketë diskutime lur bëhet fjalë për varreza.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me 11 vota pro dhe 1 kundër.

Votat pro: Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Flutur Kojku ,Fiqirete Alliu,Arjana Çekrezi,Arben Hoxha,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Bujar Vreto,Habil Biçaku.

Votat kundë: Ilir Kuka.

6.P/Vendim ““Për miratimin e Planit të Integritetit”.

Nuk ka pyetje nga Këshillatrët

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **12 vota pro.**

Votat pro: Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Flutur Kojku ,Fiqirete Alliu,Arjana Çekrezi,Arben Hoxha,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Bujar Vreto,Habil Biçaku,Illir Kuka.

7.P/Vendimi “Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit parashkollor në Bashkinë Librazhd.

Nuk ka pyetje nga Këshillatrët

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **12 vota pro.**

Votat pro: Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku, Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Arben Hoxha, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Habil Biçaku.

8.P/Vendim “Për përfshirjen në listën e familjeve që përfitojnë nga programi I strehimit.

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Në këtë rast kemi nje familje që ka bërë një kërkesë që ta përfshijmë në listën e familjeve që përfitojnë nga programi I strehimit.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **11 vota pro.**

Votat pro: Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku, Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Arben Hoxha, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Habil Biçaku, Ilir Kuka.

9.P/Vendim “Për miratimin për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë.

Përgjegjësi i zyres tek Sektori I Menaxhimit të Tokave Bujqësore, Albert Alla e merr fjalën të na sqaroj në lidhje me këtë P/vendim.

Bashkia ka interes për ti dhene me qira keto toka bujqësore pasi kjo nxit punësimin dhe zhvillimin e zones si dhe siguron te ardhura ne favor te saj. Parcelat që kërkohen të jepen me qira ndodhen ne zonen kadastrale 1715, fshati Gizavesh me nje siperfaqe totale pre 2.5236 ha në të cilen perfshihen pasurite nr.199/7, nr.201/2 nr.201/10 dhe nr 202. Procedurat do te ndiqen sipas udhëzimit nr.1 datë.18.07.2012 “Për procedurat e dhenies me qira te tokave bujqesore të pandara.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **12 vota pro.**

(Por që ky p/vendim të kaloj në vendim duhet që të votohet nga 3/5 e keshilltarëve, nuk kalon ky p/vendim pasi nuk plotesohet korumi I nevojshëm

Votat pro: Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku, Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Arben Hoxha, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Habil Biçaku, Ilir Kuka, Bujar Vreto.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BIÇAKU

